URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 8499, datë 17.10.2014

PËR PËRCAKTIMIN E DISA RREGULLAVE TË QARKULLIMIT RRUGOR NË ANSAMBLIN MONUMENT KULTURE TË AKSIT KRYESOR DHE QENDRËN HISTORIKE TË QYTETIT TË TIRANËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 7/1 të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000,"Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJMË:

Ndalohet dhe kufizohet qarkullimi i automjeteve të të gjitha kategorive, si dhe parkimi i automjeteve në zonat e sheshit "Nënë Tereza" dhe Bulevardit "Dëshmorët e Kombit", pjesë e Ansamblit Monument Kulture të aksit kryesor dhe Qendrës Historike të Qytetit të Tiranës, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a)Ndalohet qarkullimi i të gjitha kategorive të mjeteve të transportit në zonën përreth sheshit "Nënë Tereza" nga ora 19:00 deri në orën 24:00.

b) Qarkullimi i mjeteve do të kryhet si më poshtë:

- Qarkullimi i mjeteve nga rruga "Loro Borici" në drejtim të hotel "Sheraton" do të devijohet me sens lëvizjeje nga rruga "Lek Dukagjini" në drejtim të Sheshit "Italia".

- Qarkullimi i mjeteve nga sheshi "Frederik Shopen" do të devijohet me sens lëvizjeje në rrugën "Ibrahim Rugova".

- Qarkullimi i mjeteve nga rruga "Abdyl Frashëri" me drejtim lëvizje drejt bulevardit "Dëshmorët e Kombit", në kryqëzimin me bulevardin "Dëshmoret e Kombit" do të jetë detyrimisht majtas me drejtim urën e madhe të Lanës.

2. Ndalohet pushimi dhe qëndrimi i të gjitha kategorive të mjeteve të transportit rrugor në zonën përreth sheshit "Nënë Tereza", me përjashtim të mjeteve të transportit publik të linjave urbane (autobus).

3. Ndalohet pushimi dhe qëndrimi i të gjitha kategorive të mjeteve të transportit rrugor duke filluar nga sheshi "Nënë Tereza" përgjatë bulevardit "Dëshmorët e Kombit" deri te ura e madhe e Lanës në kryqëzimin me bulevardin "Bajram Curri", me përjashtim të mjeteve të transportit publik të linjave urbane (autobus).

4. Bashkia e Tiranës pajis me sinjalistikë rrugore të nevojshme, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij urdhri dhe bën ndërhyrjet e nevojshme në sistemin semaforik për të përshtatur sinjalistikën ekzistuese sipas ndryshimeve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro Furxhi

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto